

URDHËR
Nr. 1, datë 4.1.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”, nenet 22 e vijues të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të Autoritetit Kontraktor, Ministria e Punëve të Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Gazmend Barbullushi, për nënshkrimin e akteve të procedurave të prokurimit, vlera e të cilave, brenda një viti kalendarik është më e madhe se 800,000 (tetëqind mijë) lekë.
 2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data e daljes së këtij urdhri.
 3. Sekretari i Përgjithshëm nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.
 4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Ditmir Bushati